



Advocacy Center
for **Democratic Culture**

Janar
2023

BULETINI



Janar 19

Diskutim publik për gjyqësorin

Në kuadër të projektit "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe në Kosovë", i mbështetur nga INL, OJQ ACDC organizoi diskutim publik mbi gjyqësorin në veri të Kosovës. Qëllimi i diskutimit ishte prezentimi i gjendjes aktuale në institucionet e drejtësisë në dritën e ngjarjeve të fundit në veri.

Pavarësisht krizës politike që u shfaq pasi serbët u larguan nga institucionet e Kosovës, ACDC vazhdoi të bashkëpunojë me gjyqësorin, policinë dhe komunën. Gjatë diskutimit, ACDC prezantoi informata se sa persona janë larguar nga institucionet dhe si po përballon Gjykata Themelore në Mitrovicë me mungesën e punëtorëve.





January 26

Konferenca për bashkëpunimin multietnik

Konferenca përfundimtare u organizua për të promovuar bashkëpunimin e komuniteteve në Mitrovicën e Veriut dhe për të reflektuar mbi aktivitetet dhe arritjet e projektit "Promovimi i Dialogut Ndëretnik në Pushtetin Lokal", i mbështetur nga National Endowment for Democracy - NED.

Drejtori i programit nga OJQ ACDC, Aleksandar Rapajiq, prezantoi projektin dhe aktivitetet që janë realizuar, duke u fokusuar në iniciativat që janë zbatuar në tri vendbanime multietnike në komunën e Mitrovicës Veriore, ku janë mbështetur projekte të vogla lokale me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës së të gjitha komuniteteve dhe krijimi i një mjedisi miqësor dhe të qëndrueshëm për të gjithë banorët e vendbanimeve multietnike në Mitrovicën e Veriut.



Publikim i ri – Përmbledhje e Politikave


Përmbledhja e politikave ka për qëllim të vlerësojë gjendjen aktuale të çështjeve në lidhje me pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje në nivel qendror dhe lokal në Kosovë, të promovojë barazinë gjinore dhe të ofrojë rekomandime për politikën për institucionet përkatëse shtetërore.

This policy brief was created as part of the project "Women for women - united in power", implemented by the Advocacy Center for Democratic Culture (ACDC), and supported by Reactor - Research in action and their partners through the action "Furthering Gender Equality through the EU Accession Process". This Action is funded by the European Union and co-funded by Sweden. This publication was produced with the financial support of the European Union and cofunded by Sweden. Its contents are the sole responsibility of NGO ACDC and do not necessarily reflect the views of the European Union or Sweden.





Projekti e ri



Avokimi për një pozitë më të mirë të grave shtatzëna dhe nënave të reja

OJQ ACDC njofton se projekti i ri synon rritjen e njohurive mbi ligjin e punës dhe ndërgjegjësimin për pozitën e grave shtatzëna dhe nënave të reja.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të ofrojë mbështetje për gratë në Kosovë duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e mosdiskriminimit në fushën e ligjit të punës, si dhe duke identifikuar qëndrimin e qytetarëve, në radhë të parë të grave, për të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve.

Granti financohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë, në kuadër të projektit "Mbrotjtja dhe promovimi i të drejtave të punës të grupeve të cenueshme në tregun e punës", i zbatuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC, në partneritet me BIRN Kosovë.



Hulumtimi mbi pozitën e nënave të reja, grave shtatzëna dhe nënave beqare

Për të eksploruar pikëpamjet dhe opinionet e grave shtatzëna dhe nënave beqare dhe të reja në lidhje me të drejtat e tyre të punës, ACDC publikoi **anketën** në internet. Anketa është menduar posaçërisht për këtë grup të synuar. Një analizë gjithëpërfshirëse do të publikohet në muajt në vijim që do të përfshijë gjetjet dhe përfundimet e hulumtimit.

Siç u njoftua muajin e kaluar, faqja e internetit e OJQ ACDC është përditësuar dhe përmirësuar me përmbajtje të re të fokusuar në punën tonë për të fuqizuar vizibilitetin e organizatës. Kemi prezantuar seksione të reja në faqen e internetit, duke përfshirë mundësitë e punësimit dhe gjithashtu kemi zgjeruar fushat e punës dhe kemi përmirësuar strukturën e përmbajtjes së lajmeve.

Raporti vjetor 2022

Raporti Vjetor paraqet projektet dhe aktivitetet e zbatuara nga OJQ ACDC gjatë vitit 2022.



RAPORTI VJETOR




2022



Vizitë e studentëve të EMA

Më 23 janar, OJQ ACDC priti një grup studentësh nga Vjena dhe Venecia. Drejtori i programit i informoi studentët për punën e ADCD-së në promovimin e sundimit të ligjit, pozitën e komunitetit serb, integrimin e gjyqësorit në veri dhe situatën e përgjithshme politike në Kosovë.



Blagica Radovanović për pozitën e gruas në veri të Kosovës



Skender Sadiku për bashkëpunimin ndëretnik



Konferenca për bashkëpunimin multietnik



Takimi i Grupit Këshillues

KCSF @ FaceBook



Drejtori Ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radaković, mori pjesë në takimin e Grupit Këshillues, i cili përbëhet nga përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve dhe akterëve të tjerë, për të diskutuar mbi procesin e konsultimeve publike dhe mënyrat për të përmirësuar pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe politikëbërje.

Rapajiq deklaroi për N1



Drejtori i Programit, Aleksandar Rapajiq deklaroi për N1 për ndërtimin e bazës së Policisë së Kosovës në veri të Kosovës.

Drejtori i programit, Aleksandar Rapajiq u deklarua për gazetën gjermane Zeit.